



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E ISTOGUT

## KONTRATË PËR PUNË

*KOMUNA E ISTOGUT në vazhdim "Njësia e Prokurimit", të cilën e përfaqëson z. Gëzim Ademaj, U.D. i menaxherit të Prokurimit, Rruga "Fadil Ferati" Nr. 121 në njërën anë; Dhe*

*GRUPI I O E BRT Shpk & Rexha Shpk Komuna e Prishtinës , të cilën e përfaqëson I autorizuari z. Indir Jashari, me Nr. Unik i Rexh. Biznesi, 810077356 (ne vazhdim "Kontraktuesit"), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:*

### TITULLI I KONTRATËS:

#### RREGULLIMI I TROTUAREVE NË ISTOG

<i>Nr. I prokurimit</i>	<i>633-20-5352/ 5-2-1/ C421</i>
<i>Nr. I brendshëm</i>	<i>633 / 020 / 085/ 521</i>

### Neni 1 Lënda

*1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i furnizimeve dhe punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit:*

#### RREGULLIMI I TROTUAREVE NË ISTOG

N

### Neni 2 Çmimi

*2.1 Çmimi i punëve per aktivitetin e prokurimit: RREGULLIMI I TROTUAREVE NË ISTOG është: 33.691,15 dhe me fjalë: /Tridhjetetremijëegjashtëçindenëntëdhjetëenjëeuro 15 /100 €*

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve përgjatë ekzekutimit të kontratës.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

### **Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës**

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Marrëveshja e kontratës;  
Kushtet e Veçanta të Kontratës;  
Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;  
Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet  
Teknike;  
Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);  
Plani për menaxhimin e kontratës

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

### **Neni 4 Afati i përmbushjes së kontratës:**

4.1. Të gjitha punimet sipas kësaj kontrate do të përfundojnë brenda 30 ditëve, nga data e nënshkrimit të kontratës, e me se larti deri me 21.12.2020

### **Neni 5 Ndërprerja e kontratës:**

5.1 Kjo kontratë mund të shkëputet kurdo që kontraktori nuk i respekton kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës të parapara në dosjen e tenderit, dhe kur për një gjë të tillë plotësohen këto kushte.

### **Neni 6 Komunikimet**

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.





6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

6.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

6.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

**Për: Autoritetin Kontraktues:**  
**Komuna e Istogut**

**Për: Kontraktuesin:**  
**"BRT" Shpk & "Rexha" shpk**

<b>Emri:</b>	Gëzim Ademaj	<b>Emri:</b> PER	Fisnik Blakaj
<b>Pozita:</b>	U.D. Menaxher-it të Prokurimit	<b>Pozita:</b>	P r o n a r
<b>Nënshkrimi:</b>		<b>Nënshkrimi:</b>	
<b>Data:</b>		<b>Data:</b>	26.11.2020
<b>Vu la</b>		<b>Vu la</b>	

### PJESA III E KONTRATES kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

*[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]*

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulojnë nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë GJUHA SHQIPE
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është 10% e vlerës së kontratës, me vlefshmeri 60 dite me gjate se perfundimi i kontratës.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: Sigurimi i vend punishtes do te jete përgjegjësi e Operatorit Ekonomik dhe te gjitha dëmtimet e punëve, dëmtimet e pronës apo humbjet e materialeve dhe pajisjeve ne vend punishte janë ne përgjegjësi te Operatorit ekonomik deri ne shumen e dëmtimeve apo humbjeve, sigurimi i vend punishtes do te jetë + 30 dite nga plani dinamik i ofruar pra nëse zgjasin punimet zgjatet edhe sigurimi i vend punishtes pra + 30 dite.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të caktohet në <i>planin e menaxhimit</i>
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë 30 ditë.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% për ditë por jo më shume se 10% e vlerës së kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Ditari i Punës dhe Libri ndërtimor
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit është <i>i caktuar me vendim të ZKA</i>
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë 5 ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është 1 vite
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Palët do te provojnë ne mënyrë miqësore ti zgjidhin marrëveshjet ku do te organizojnë se paku tre takime për zgjidhje miqësore e nëse këto takime nuk kane efekt atëherë kompetente do te jetë gjykata.
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykata Themelore në Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë

## PARAMASA

Projekti: "Rregullimi i trotuarëve në Istog(Zona Urbane)"

Nr.	Pozicioni	Njësia	Sasia	Çmimi njësi	Çmimi total
				€	€
<b>I INÇIZIMET DHE PUNËT PARAPRAKE NË TEREN</b>					
1.1	Vendosja e shenjave të përkohshme vertikale dhe shenjave për kontrollë të trafikut gjatë kryerjes së punimeve dhe sigurimi i komunikacionit gjatë punimeve në rrugë.	m'	1350	0.25	337.50
1.2	Shënimi i trasesë si dhe përcjellja e punimeve gjeodezike gjatë ekzekutimit, si dhe hartimi i projektit të ekzekutuar.	m'	1350	0.74	999.00
1.3	Shqyrtimi I të gjitha prova për të gjitha shtresat e rrugës në laborator sipas kërkesës së investitorit(Nenbazes,shtreses stabilizuese, Tampon 0-60, Tamponit 0-30, kubëzave etj..)	m'	1350	0.15	202.50
<b>2 PASTRIMI I TERENIT</b>					
2.1	Mobilizimi dhe rregullimi i punishtes për punë si dhe largimi i të gjitha llojeve instalimeve në punishte në rast se ka në ato hapësira.	m'	1350	0.20	270.00
<b>3 PUNËT TOKËSORE</b>					
3.1	Gërmimi i dheut i kategorisë së III- IV-të me ngarkim dhe bartje deri në deponi në largësi max. 5km (në çmim të parashihet edhe demolimi i asfaltit ekzistues, kubzave dhe skajoreve me ngarkim dhe bartje deri në deponi)	m <sup>3</sup>	1147.5	0.87	998.33
3.2	Formësimi dhe ngjeshja e nënbuzës së trupit të rrugës me ngjeshmëri 30MN/m <sup>2</sup>	m <sup>2</sup>	2295	0.20	459.00
<b>4 KONSTRUKSIONI I TRASËS SË RRUGËS</b>					
4.1	Punimi i mbushjes me material stabilizues të granular (60MN/m <sup>2</sup> ) të trupit të rrugës me CBR>15%	m <sup>3</sup>	229.50	6.00	1,377.00
4.2	Punimi i tamponit (80MN/m <sup>2</sup> ) prej gurit të thyer gëlqeror 0-63mm me trashësi t=20cm në rrugë dhe trotuare	m <sup>3</sup>	459.00	4.00	1,836.00
4.3	Furnizimi, transporti dhe punimi i tamponit (100MN/m <sup>2</sup> ) prej gurit të thyer gëlqeror 0-32mm me trashësi t=10cm.	m <sup>3</sup>	229.50	5.00	1,147.50
4.4	Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e kubëzave të betonit t=8cm ,te vendosura në shtrese rëre frak. 2/4 mm, t=4cm. Në pozicion përfshihet edhe mbushja e fugave me rërë të imët dhe vendosja e shiritave në të dy anët e trotuarit me kubeza me ngjyrë.	m <sup>2</sup>	2,025.00	5.00	10,125.00
4.5	Furnizimi, bartja dhe vendosja e skajorëve me dim. 18/25 mbi shtrese betoni.	m'	1,350.00	4.60	6,210.00
4.6	Furnizimi, bartja dhe vendosja e skajorëve me dim. 8/25 mbi shtrese betoni	m'	1,350.00	3.60	4,860.00
				<b>Totali:</b>	<b>28,551.83</b>
<b>REKAPITULIM</b>					
<b>Totali</b>			<b>28,551.83 €</b>		
<b>TVSH(18%)</b>			<b>5,139.33 €</b>		
<b>Totali+TVSH(18%)</b>			<b>33,691.15 €</b>		

